**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA CËRRIK**

**Data: 20.11.2024**

**<u>PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË</u>**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROKURIMIT**: ***"RIKONSTRUKSIONI I KONVIKTIT TE SHKOLLES MESME BUJQESORE "MIHAL SHAHINI " QYTETI CERRIK***

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV)**: **Punime ndërtimi 45210000-2**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 72267467** (*shtatedhjete e dy milion e dyqind e gjashtedhjete e shtate mije e katerqind e gjashtedhjete e shtate*) lekë pa TVSH
Perllogaritja e fondit limit dhe specifikimeve teknike eshte kryer nga inxhinier i licensuar referuar nenit 76 të pikës (a) të VKM-së me nr.285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave "Për rregullat e prokurimit publik" i ndryshuar, që përcakton "çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj", Inxhinieri është mbështetur ne manualin teknik te çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre bazuar ne ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar. - VKM nr. 216, datë 13.04.2023 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve" - Udhëzimi nr.2, datë 08.05.2003 "Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit", të ndryshuar. me qëllim që vlera limit e kontratës, të jetë një vlerë e matshme dhe njëkohësisht e të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", autoriteti/enti kontraktor ***<u>Bashkia Cerrik</u>*** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

*a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;*
*b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës 8*

**Argumentimi**: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

Sipas kritereve të përgjithshme të pranimit / kualifikimit

**Argumentimi**: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

**2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023 , ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e fondit limit te vene ne dispozicion.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: *Ne lidhje me situaten ekonomike dhe financiare, autoritetit ose entet kontraktore mund te vendosin kerkesa qe garantojme qe operatoret ekonomike kane kapacitetin e nevojshem ekonomik dhe financiar per te zbatuar kontraten","Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.", si dhe bazuar ne nenin 43, pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik": Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:a) dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar''. Vendosja e ketij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Për ketë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qellim, është argumentuar se vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së përllogaritur/ fondit limit.*

---

*Përcaktimi i vitevetë kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore": "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të ketij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.*

2.2.2 Kopje të deklarimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tri) viteve të fundit financiare (2021,2022,2023) lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që po prokurohet. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

*Përcaktimi i vitevetë kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave*

*Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".*

2.2.3Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin2023 dhe për vitin 2024 ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", (i ndryshuar). Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

**Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotesimin e formularit te vetedeklarimit, dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" dhe ne ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar, ne ligjin nr.9920 date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore" i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dheneni 40, ne ligjin nr.131/2015 "Per QKB" i ndryshuar, si dhe ne ligjin nr.9723 date 03.05.2007 "Per QKR" i ndryshuar.

**2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

**2.3.1. Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:**

**a.** Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo me të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit te kontratës.

**b.** Punë të ngjashme deri ne nje kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë jo me te vogel sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet .

Plotesimi i njerit prej dy kushteve te siperpermendura e ben oferten te kualifikueshme.

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

**Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:**

a) Për kontrata të realizuara me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
- Formular vleresimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
- Kontratë Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;

- Aktin e kolaudimit;
- Çertifikaten e marrjes ne dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes ne dorezim.

b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular vleresimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9 (ku të përcaktohet vlera, afati i perfundimit te kontrates si dhe natyra e punes se kryer);
- Kontrate Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Aktin e kolaudimit;
- Çertifikaten e marrjes ne dorëzim/ Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorëzim;
- Fatura tatimore përkatese.

Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë: Kontraten e Bashkimit te operatoreve ekonomik si dhe prokuren e posacme te deklaruar ne fazen e tenderimit.

Për kontratat e realizuara si nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë: kontratën baze ndermjet kontraktorit dhe autoritetit kontraktor, kontraten e nenkotraktimit dhe aktin e miratimit zyrtar si nenkontraktor.

***Argumentimi***: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 (*ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4*), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose dyfishi i vleres se fondit limit për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo me te vogel se dyfishi i vlerës limit të objektit te prokurimit për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:Vlera e kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e kërkuar është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme si dhe përvojën e duhur, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

### 2. 3.2 Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:

Operatori Ekonomik duhet te disponoje Liçencë të shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

- NP–1 A Punime gërmimi në tokë.
- NP–2 C Ndërtime civile dhe industriale.
- NP–3 C Rikonstruksion dhe mirembajtje godinash civile dhe industriale
- NP–11 A Ndërtime për nënstacionet, kabinat e transformatorëve, linja e tensionit të lartë e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.
- NP–12 A Punime të inxhinierisë së mjedisit.
- N.S-1 A Punime per prishjen e ndertimeve
- N.S-2 A Impiante hidro-termosanitare dhe mirëmbajtja e tyre.
- NS-4 C Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese.

- NS-12 A Impiante teknologjik, termik dhe te kondicionimit.
- NS-13 A Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacione
- NP–14 B Impiante te brendeshme ,elektrike telefoni ,radiotelefoni etj.
- NS-18 A Punime topogjeodezike

sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licensave profesionale sipas legjislacionit në fuqi.

*Operatorët e huaj duhet të plotësojnë kërkesat e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës sipas përcaktimeve më sipër. Operatori ekonomik i huaj të ketë në licencën e tij ato kategori punimesh të kërkuara në dokumentat e tenderit, pavarësisht se kategoria e kërkuar, nuk korespondon me të njëjtin numër kategorie me kategorinë e punimeve në licencën e një operatori të huaj të lëshuar nga vendi i origjinës.*

***Argumentimi**:* Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", si dhe Vendim te Keshillit te Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008, "Per miratimin e rregullores per kriteret dhe Procedurat e dhenies se licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te Subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, gjithashtu Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit",neni 8 përcakton "Zbatimi I punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, private ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet te sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në perputhje me standartet kombëtare ose europiane.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

| Kategoria e kërkuar | Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës | Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse | Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë në respektive | Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse |
|---|---|---|---|---|
| NP–1 A | Punime gërmimi në tokë. | 37 3.138 Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, ne themele gjeresi, toke zak, kategoria III, me shkarkim ne toke<br>38 3.158/5a<br>Transport dheu me auto deri 5.0 km<br>39 3.138 Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, ne themele gjeresi, toke zak, kategoria III, me shkarkim ne toke<br>40 3.158/5a<br>Transport dheu me auto deri 5.0 km | A | 0-20 milion |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | 41 3.138 Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, ne themele gjeresi, toke zak, kategoria III, me shkarkim ne toke<br>42 3.158/5a<br>Transport dheu me auto deri 5.0 km | | |
| NP–2 C | Ndërtime civile dhe industriale. | Vete objekti e percakton nevojen per kete license ( rikonstruksion i godines se konviktit)/ | C | 51 – 100 milion lekë |
| NP–3 C | Rikonstruksion dhe mirembajtje godinash civile dhe industriale | Vete objekti e percakton nevojen per kete license ( rikonstruksion i godines se konviktit)/ | C | 51 – 100 milion lekë |
| NP–11 A | Ndërtime për nënstacionet, kabinat e transformatorëve, linja e tensionit të lartë e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë. | Sipas percaktimeve ne preventiv | A | 0-20 milion |
| NP–12 A | Punime të inxhinierisë së mjedisit. | Sipas percaktimeve ne preventiv | A | 0-20 milion |
| N.S-1 A | Punime per prishjen e ndertimeve | 2. PUNIME SHTRESASH<br>4 3.197/2 Prishje shtresash ekzistuese, t=10cm. | A | 0-20 milion |
| N.S-2 A | Impiante hidro-termosanitare dhe mirëmbajtja e tyre. | 60 2.488 F V rezervuari zingato 5000 litra<br>61 2.491/f FV Tuba e rakorderi ujesjellesi PE d=63mm, Pn 16<br>62 2.494/5 F.V saracineska bronzi Ø 2 " = 50 mm<br>63 2.494/5 F.V saracineska bronzi Ø 2 " = 50 mm<br>64 2.491/c FV Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=20~32mm, Pn 16<br>65 2.491/c FV Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=20~32mm, Pn 16<br>66 2.491/c FV Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=20~32mm, Pn 16<br>67 2.491/d FV Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=40mm, Pn 16 | A | 0-20 milion |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | 68 2.491/e FV Tuba e rakorderi ujesjellesi PE d=50mm, Pn 16<br>69 2.491/f FV Tuba e rakorderi ujesjellesi PE d=63mm, Pn 16<br>70 2.535/a Termoizolim tubi Ø 1/2" me armofleks (d22x9)<br>71 2.535/b Termoizolim tubi Ø 3/4" me armofleks (d28x9)<br>72 2.535/b Termoizolim tubi Ø 3/4" me armofleks (d28x9)<br>73 2.535/d Termoizolim tubi Ø 11/4" me armofleks (d42x9)<br>74 2.535/f Termoizolim tubi Ø 11/2" me armofleks (d54x9)<br>75 2.535/g Termoizolim tubi Ø 2" me armofleks (d64x9)<br>76 2.494 F.V saracineska bronzi Ø 1/2 " = 15 mm<br>77 2.494/1 F.V saracineska bronzi Ø 3/4 " = 20 mm<br>78 2.494/2 F.V saracineska bronzi Ø 1 " = 25 mm<br>79 2.494/3 F.V saracineska bronzi Ø 1 1/4 " = 32 mm<br>80 2.495 F.V lavaman porcelani<br>81 2.501 F.V WC allafrenga<br>82 2.515 F.V pilete dyshemeje Ø 50 | | |
| NS-4 C | Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese. | 6. PUNIME MURATURE TULLE<br>22 2.70/2 Mur me tulla te lehtesuara deri - 3 m, LL.P. M-25<br>23 2.71/2 Mur me tulla te lehtesuara dopio deri 8 m, LL.P. M-25 10. PUNIME SHTRESASH 2<br>32 2.262/4 Shtrese betoni C 16/20<br>33 2.267/1 Shtrese me pllaka porcelanat | C | 51 – 100 milion lekë |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | 34 2.267b Shtrese me pllaka grez importi, 40x40cm<br>35 2.262/4 Shtrese betoni C 16/20 | | |
| NS-12 A | Impiante teknologjik, termik dhe te kondicionimit. | 84 An F.V. Kabell nje polar I tensionit te mesem tip XLPE 12/20 kV, i Prysmian ose ekuivalent:<br>Furnizim vendosje te kabllit te fuqise nje polar i tensionit te mesem i tipit XLPE 12/20 kV, jo perhapes se zjarrit dhe jo perhapes se flake, : 1x240mm²<br>85 An V.Panel elektrik kryesor shperndares me kompartiment metalik deri ne 1000A I Schneider Electric - PEK : Furnizim vendosje kuader elektrik shperndarje centraline metalike, shkalle mbrojtjeje IP40, IK07 dhe realizim te dallueshem nga skemat projektit, i formuar nga centralina m<br>86 An V.Kuader elektrike centraline PVC, tip modular per mure , I Schneider ose ekuivalent:PE Furnizim vendosje kuadri elektrike shperndaje energjise elektrike , ne egzekutim dhe shkalle mbrojtjeje minimale te dallueshme nga skemat e projektit 36 M, IP31,IK07, i formuar nga centralina e dimensioneve te<br>87 An Panel elektrik kryesor shperndares me kompartiment metalik deri ne 63A I Schneider Electric - PE-SK : Furnizim vendosje kuader elektrik shperndarje centraline metalike, shkalle mbrojtjeje IP40, IK07 dhe realizim te dallueshem nga skemat projektit, i formuar nga centralina me<br>88 An V.Panel elektrik kryesor shperndares me kompartiment metalik deri ne 125A I Schneider Electric - PE- | A | 0-20 milion |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | Lav : Furnizim vendosje kuader elektrik shperndarje centraline metalike, shkalle mbrojtjeje IP40, IK07 dhe realizim te dallueshem nga skemat projektit, i formuar nga centralina<br>89 An Kabell fuqie multipolar tip FG16(OR16, 1x300mm2:<br>Furnizim vendosje kablli elektrik tip me dopio izolacion trepolar plus toka, shtrire ne pasarele kabllore te kontabilizuar vecmas, tipi jo perhapes se<br>90 An Kabell fuqie multipolar tip FG16(OR16, 1x120mm2:<br>Furnizim vendosje kablli elektrik tip me dopio izolacion trepolar plus toka, shtrire ne pasarele kabllore te kontabilizuar vecmas, tipi jo perhapes se<br>91 An Kabell fuqie multipolar tip FG16(OR16, 5x16mm2:<br>Furnizim vendosje kablli elektrik tip me dopio izolacion trepolar plus toka, shtrire ne pasarele kabllore te kontabilizuar vecmas, tipi jo perhapes se<br>92 An Kabell fuqie multipolar tip FG16(OR16, 5x6mm2:<br>Furnizim vendosje kablli elektrik tip me dopio izolacion trepolar plus toka, shtrire ne pasarele kabllore te kontabilizuar vecmas, tipi jo perhapes se zj<br>93 An Kabell fuqie multipolar tip FROR, 3x1.5mm2:Furnizim vendosje kablli elektrik tip FROR,me izolacion special quality TI2,<br>94 An Kabell fuqie multipolar tip FROR, 3x2.5mm2, i General Cavi ose | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | ekuivalent: Furnizim vendosje kablli elektrik tip FROR,me izolacion special quality TI2,<br>95 An Kabell fuqie multipolar tip FG16(OR16, 3x4mm2:<br>Furnizim vendosje kablli elektrik tip FG16(OR16,me dopio izolacion , shtrire ne pasarele kabllore te kontabilizuar vecmas, tipi jo perhapes se zjarrit<br>96 An Kabell fuqie multipolar tip FG16(OR16, 3x6mm2:<br>Furnizim vendosje kablli elektrik tip FG16(OR16,me dopio izolacion , shtrire ne pasarele kabllore te kontabilizuar vecmas, tipi jo perhapes se zjarrit<br>97 An Kabell fuqie multipolar tip FTG10(O)M1, 5x6mm2:<br>Furnizim vendosje kablli elektrik tip FTG10(O)M1,me dopio izolacion , shtrire ne pasarele kabllore te kontabilizuar vecmas, tipi jo perhapes se zjarrit d<br>98 An Kanaline e birezuar , hekuri te zinguar sendzimir 200x75mm, IP20, i Femi-CZ ose ekuivalente. Furnizim vendosje kanaline hekuri te zinguar sendzimi, komplet me kthesa, pjese te vecanta, stafa mbeshtetese/ varje me profil hekuri te zinguar ne te nxehte. Kanaline 100x75mm<br>99 An Percjelles tip FG17 , 1x1.5mm2 . Furnizim vendosje percjelles tip FG17 , 1x1.5mm2 , shtrire ne tuba plastik, tipi jo perhapes se zjarrit dhe jo perhapes te flakes, | | |
| NS-13 A | Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacione | 144 An V.Rack kryesor per transmetimin e datave : Furnizim vendojse te Rack 42U me dimensione (lxpxh) 800x800x2200mm. Strukture | A | 0-20 milion |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | mbajtese e realizuar me 2 telajo rack 19" ( telajo te salduar), sipas standartit EN<br>145 An Ftohes per rack 42<br>146 An Mbajtese pajisje<br>147 An Suport me 6 priza universale 1HE Fanton<br>148 An Kalim kabllash<br>149 An Patch Panel 24 port RJ45 per Rrjetin<br>150 An Patch Cord 0.5m per Rjetin<br>151 An Switch Cisco 24 porta<br>152 An UPS 3kVA-220V rack-mount<br>153 An Prize RJ45 Cat6 : : Furnizim vendosje te prizes RJ45 Cat6. I kompletuar me lidhje, kabllim, kolaudim dhe me te gjitha aksesoret e nevojshem per nje instalim te plote.<br>154 An Kabell per rrjet datash FTP Cat.6e : Furnizim vendosje te kabllit per transmetim te dhenash me shpejtsi te larte te tipit te perdredhur, me 4 kopje me baker njefijor dhe seksion AWG24, izolacione ne | | |
| NP–14 B | Impiante te brendeshme ,elektrike telefoni ,radiotelefoni etj. | 144 An V.Rack kryesor per transmetimin e datave : Furnizim vendojse te Rack 42U me dimensione (lxpxh) 800x800x2200mm. Strukture mbajtese e realizuar me 2 telajo rack 19" ( telajo te salduar), sipas standartit EN<br>145 An Ftohes per rack 42<br>146 An Mbajtese pajisje<br>147 An Suport me 6 priza universale 1HE Fanton<br>148 An Kalim kabllash<br>149 An Patch Panel 24 port RJ45 per Rrjetin | B | 21-50 milion |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | 150 An Patch Cord 0.5m per Rjetin<br>151 An Switch Cisco 24 porta<br>152 An UPS 3kVA-220V rack-mount<br>153 An Prize RJ45 Cat6 : : Furnizim vendosje te prizes RJ45 Cat6. I kompletuar me lidhje, kabllim, kolaudim dhe me te gjitha aksesoret e nevojshem per nje instalim te plote.<br>154 An Kabell per rrjet datash FTP Cat.6e : Furnizim vendosje te kabllit per transmetim te dhenash me shpejtsi te larte te tipit te perdredhur, me 4 kopje me baker njefijor dhe seksion AWG24, izolacione ne | | |
| NS-18 A | Punime topogjeodezike | Sipas percaktimeve ne preventiv | A | 0-20 milion |

**2.3.3.** Operatori ekonomik duhet të ketë një punësim mesatar minimumi 75 (shtatedhjete e pese ) punonjës të vërtetuar me: Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve minimumi për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave dhe listpagesat përkatëse të konfirmuara nga autoritetet përgjegjëse, shoqëruar me formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

*(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, dokumentet perkatesevertetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).*

**Argumentim:** Ky kriter është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021"Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimi. Autoriteti kontraktor në përcaktimin fuqisë punëtore te nevojshme për realizimin e kontratës ka bërë një përllogaritje të saktë të numrit të punonjësve duke përcaktuar fillimisht orët e punës në bazë të analizës sipas manualit te çmimeve të ndërtimit miratuar me VKM nr. 216, datë 13.04.2023 "*Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve*"Në këtë kontekst, autoriteti kontraktor ka përcaktuar numrin e punonjësve referuar një përllogaritje të saktë të bërë referuar zërave të punimeve per objektin e prokurimit, orëve të punës (8 ore ne dite për cdo punonjës) afatit kohor te realizimit te kontrates si dhe shperndarjes se punes.

**2.3.4.** Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet te kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të përfshirë në liçensën e shoqërise, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes se ofertave, konkretisht:

- ✓ 1 (një) Inxhinier Ndertimi
- ✓ 1 (një) Inxhinier Ndërtimi Profili Strukturist;
- ✓ 1 (një) Inxhinier Gjeoteknik
- ✓ 1 (një) Inxhinier Hidroteknik;
- ✓ 1 (një) Inxhinier Elektrik;
- ✓ 1 (një) Inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshajder;
- ✓ 1 (një) Inxhinier Mjedisi
- ✓ 1 (një) Arkitekt
- ✓ 1 (një) Inxhinier mekanik
- ✓ 1 (një) Inxhinier elektronik

-Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të deklaroje se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt sipas Udhëzimi Nr. 2, datë 13.05.2005 " Për zbatimin e punimeve të ndërtimit".

-Operatori ekonomik duhet të deklaroje se Drejtuesit Teknik te mesiperm jane te punesuar ne perputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi".
Për drejtuesit Teknik të kërkuar të paraqitet:

a) Librezë pune;
b) Kontratë pune e vlefshme;
c) Diplomë përkatëse.

*(Në rastin e Bashkimit të Operatoreve Ekonomik secili Operator duhet të plotesoje pikat dhe deklaratat e mësipërme në varësi të vlerës dhe zërave të preventivit të punimeve që ka marre persiper sipas përqindjes se bashkepunimit).*

**2.3.5.** Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/çertifikuar si:

a) 1(një) specialist Ekspert Zjarrfikes ne fushen e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin në përputhje me klauzolat Ligjit Nr.152/2015 "Për sherbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin", Neni 49, pika 4, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për periudhen e fundit të deklaruar nga data e hapjes se ofertave.

*Shënim : Disponimi i specialistit "Ekspert Zjarrfikës", mund të sigurohet nga operatori edhe me anë të kontratave të punës , të cilat të jenë të vlefshme gjatë gjithë kohës së ekzektimit të kontratës.*

b**)** 1 (një) punonjës i pajisur me çertifikatë "Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave" e cila të jetë e lëshuar nga shoqeri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për periudhen e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

c) 1 (një) punonjës me çertifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, datë 05.05.2010 Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier",

shoqëruar me kontratë individuale punë të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi per periudhen e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave.

*(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotesimin e formularit te vetedeklarimit dhe deklaratave te mesiperme, dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).*

***Argumentim:*** Autoriteti Kontraktor argumenton se kërkesa për *Përgjegjësin për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë*" është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar), Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr.285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma "c", si dhe në mbështetje të Nenit 7 të Ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010, "*Për sigurinë dhe shëndetin në punë", sipas të cilit: „Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarës që të merren me cështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë*.......".

Natyra e kontratës dhe specifikat e sajë kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënës zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

Theksojmë se, Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DST, duke respektuar çdo rregull lidhur me kantierin e ndërtimit si dhe me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Është e rëndësishme që punimet të realizohen brenda një kantieri të sigurt duke mbrojtur jetën e punonjësve, por dhe të kalimtarëve që mund të jenë përreth vendit të punimeve. Për sa më lart, punonjësit e kerkuar, nëpërmjet dijes dhe eksperiencës të fituar në këtë fushë, duhet të shmangë apo parandalojë çdo rrezik që mund të shfaqet gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që mund të cënojë shëndetin apo sigurinë në punë. Në këto kushte, vendosja e këtij kriteri shërben si një garanci që Ofertuesit do të realizojnë punimet sipas standarteve ligjore në fuqi.

"Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave" rekomandohet te jete ne kantier ne rast aksidentesh ne pune.
Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë" rekomandohet te jete ne kantier per minizimin e aksidenteve ne pune.
Në lidhje me kërkesën për disponimin e **1** *(një)* specialisti ekspert zjarrëfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin, njësia e prokurimit vlerëson se, kjo kërkesë është në përputhje me kontratën objekt prokurimi, pasi stafi operacional i operatorit ekonomik duhet të jetë i trajnuar për çdo rast emergjence, ku ndër to janë edhe rastet e zjarrit, kërkesë kjo bazuar në parashikimet e nenit 38 të Ligjit Nr. 152/2015 *"Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin"*, **në të cilin përcaktohet se, personat fizikë dhe juridikë zbatojnë dispozitat e parashikuara nga ky ligj dhe akte të tjera nënligjore, në lidhje me marrjen e masave për parandalimin e pakësimin e zjarreve, me anë të mjeteve, sistemeve, pajisjeve të diktim-sinjalizimit për shuarjen e zjarreve, gjatë kryerjes së aktivitetit të tyre**.

**2.3.6.** Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik për kryerjen e punimeve, të vërtetuar me kontratë punë te vlefshme, diplomë lëshuar nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve, si dhe të figurojnë në

listpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes se ofertave, si më poshtë:

- 2 (dy) Teknik ndërtimi
- 1 (një) Teknik topograf
- 1 (një) Teknik mekanik
- 3 (tre) punonjës hidraulik
- . 2 ( dy ) punonjes specialist CCTV
- 4 (kater) punonjës elektriçist
- 3 (tre) punonjës bojaxhi
- 4 (katër) punonjës murature/suvatues
- 2 (dy) punonjës hekurkthyes
- 2 (dy) punonjës karpentier
- 2 (dy) punonjës betonues
- 2 (dy) punonjës pllakashtrues
- 1 (nje) punonjës specialist sisteme ngrohje/ftohje
- 1 (nje) punonjës saldator
- 1 (një) punonjës hidroizoules
- 2 (dy) punonjës për punime gipsi
- 2 (dy) punonjës për punime në lartesi
- 2 (dy) punonjës manovrator / automakinist
- 2 (dy) punonjës manovrator/ ekskavatoriste
- 1 (një) punonjës buldozerist
- 2 (dy) punonjës shofer
- 15 (pesëmbedhjetë) punonjës të thjeshtë ndërtimi.

**2.3.6/1** Për stafin teknik, ofertuesi duhet të paraqesë:

- Kontratë individuale të punës të vlefshme;
- Diplomë që të vërtetojë kualifikimin profesional të mësipërm duhet të jenë të lëshuara nga instuticione të licensuara nga organet përkatëse, mbështetur ne Ligjin Nr. 15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë";
- Çertifikate e sigurimit Teknik e vlefshme, lëshuar nga institucione të autorizuara nga /ish (IQT), e cila duhet te jete e leshuar nga shoqeri te akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqiperisë.

**2.3.6/2** Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për punonjësit sipas pikës 6, emrin/mbiemer, profilin e punes, numrin dhe titullin e kualifikimit për diplomën përkatëse, si dhe institutcionin që ka lëshuar këtë dokument, numrin e certifikates së Sigurimit Teknik si dhe institutcionin që ka leshuar këtë dokument.

**2.3.6/3** Për punonjesit manovrator/ ekskavatoriste/shofer/ buldozerist ofertuesi duhet të paraqesë:

- kontratën individuale të punës te vlefshme;
- leje drejtimi, certifikate e aftesise profesionale/Patent Manovrimi nga DPSHTRR.

-Në rastin kur punonjësit manovrator/shofere janë të kontraktuar me kontratë pune, respektivisht për mjetet e marra me qera, nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).

**2.3.6/4** Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për punonjësit manovratorë, emrin/mbiemer, profilin e punës, numrin e dëshmisë së aftësisë profesionale si dhe afatin e vlefshmerise .

**Argumentimi per pikat 2.3.4, 2.3.6:** Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa "c".

